

VENDIM
Nr. 251, datë 30.4.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 649, DATË 16.10.2024, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES ‘PËR
KUSHTET DHE KRITERET E USHTRIMIT TË VEPRIMTARISË SË STACIONIT
TË PLAZHIT’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 64, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nenin 14 të rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 649, datë 16.10.2024, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, fjalët “... deri në datën 31 maj.” zëvendësohen me “... brenda muajit qershor.”;
2. Në pikën 6, fjalët “... brenda datës 30 prill.” zëvendësohen me “... brenda muajit qershor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku